

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan- dega në Kamenicë, përmes gjyqtares së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të pandehurit D.S. nga fsh. ..., K. e, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 parag. 5 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjiilani, PP.nr.1147/2013 i dt.24.06.2013, në shqyrtimin e hapur gjyqësor, në prani të prokurorit të shtetit Esat Ademi, të akuzuarit D.S., më datë 08.12.2016 komunikoi, ndërsa më dt.19.12.2016 përpiloi këtë.

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

D.S., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, i lindur më datë „data e lindjes,, në fsh. ..., K. e ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i dënuar më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Në pajtim të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 i KPPRK-së,

Lirohet nga akuza

Sepse më datë 10.06.2013, rreth orës 18.00-18.15, në afërsi të fshatit, Komuna e Kamenicës, i pandehuri ka penguar personat zyrtar, të dëmtuarit A.TH. dhe SH.B. të dy pjesëtar të policisë së Kosovës, në kryerjen e detyrave zyrtare duke përdorur kamionin e tij të markës “”, me ngjyrë portokalli, me „tabela të regjistrimit,, dhe vazhdon rrugën nga për në e me qëllim të kalimit të kufirit. Në dalje të fshatit policia tenton ta parakaloj kamionin e të pandehurit kurse në këtë moment i pandehuri kamionin e tij e lëviz nga shiriti i tij qarkullues e në mesin e rrugës duke rrezikuar kështu seriozisht jetën e pjesëtarëve të policisë së Kosovës dhe duke përdorur kamionin e tij si mjet të forcës dhe duke penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare .

- me çka kishte për të kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 parag. 5 lidhur me parag. 1 të KPRK-së.

Të dëmtuarit A.TH. e SH.B. nuk parashtruan kërkesë pasurore juridike.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.1147/2013 prej datës 24.06.2013, ka akuzuar D.S. nga f.sh. për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtare në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 parag. 5 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, pran të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin.

I dëmtuari A.TH. në fjalën e tij përfundimtare deklarohet se, nuk iu bashkangjitet ndjekjen penale dhe nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike.

I dëmtuari SH.B. në fjalën e tij përfundimtare deklarohet se, iu bashkangjitet ndjekjen penale ndërsa nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari D.S. gjatë paraqitjes së mbrojtjes në seancën për shqyrtim gjyqësor, deklaroi se, lidhur me rastin është intervistuar në polici dhe mbetet pranë asaj deklarate nuk konteston faktin se posedon kamion, mirëpo konteston në tërësi faktin se ditën konkrete ka qenë duke drejtuar kamionin ashtu siç është përshkruar në aktakuzë, ditën konkrete ka qenë në dhe me tu k'thyer në fshatin, është ndaluar nga policia, është informuar se duhet të shkojë në stacion policor për të dhënë deklaratë ku edhe iu është përgjigjur ftesës, jeton në bashkësi familjare me prindërit, kamionin përpos tij e vozisin edhe vëllai, djemtë e axhës dhe ndodhë që këtë kamion tu ua japin fshatarëve për nevoja të tyre, në fjalën përfundimtare nuk pranon se ka kryer veprën penale të cilën ia vë në barrë prokurori i shtetit me arsyetimin se ditën konkrete nuk ka qenë duke drejtuar kamionin, andaj kërkon nga gjykata që të shqyrtoj sa ma drejt të gjitha provat të cilat gjenden në lëndë dhe të merr një vendim meritator ta liroj nga përgjegjësia penale.

Gjykata në procedurën provuese ka dëgjuar të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarëve: A.TH. e SH.B., dëshmitarin I.K., ndërsa prova materiale për tu shqyrtuar nuk ka patur.

Dëshmitarët, A.TH. e SH.B. në dëshmitë e tyre kanë deklaruar, se, ditën konkrete gjatë patrullimit kanë vërejtur një kamion me ngjyrë të verdhë të tipit “....” i cili kamion për ta ka qenë i dyshimt pasi ka lëvizur në drejtim të fsh. R.e ..., për çka edhe e kanë përcjellë, i njëjti kamion për dy orë nuk ka lëvizur nga hyrja e fsh., për këtë shkak edhe nuk e kanë përcjellë më, mirëpo pas një kohe kanë vërejtur të njëjtin kamion duke ardhur nga fsh. ... në drejtim të fsh. ... , ju janë vënë pas duke e paralajmëruar me dritë rrotative- alarm, që vozitësi të ndalet mirëpo i njëjti nuk është ndaluar, gjatë përcjelljes kanë marr numrin e targave të kamionit , kanë tentuar ta parakalojnë që ta ndalin mirpo nuk kanë pasur mundësi pasi vozitësi i kamionit ka dalur edhe në shiritin tjetër qarkullues dhe i ka penguar, i njëjti kamion është kthyer në drejtim të fshatit të ... dhe për shkak që i njëjti ka kaluar kufirin e Republikës së Kosovës të njëjtin nuk kanë mundur ta ndalin, pasi janë kthyer në stacionin policor kanë bërë verifikimin e targave të kamionit

dhe kanë vërtetuar se ky kamion është pronë e D.S. Janë shkuar në shtëpinë e D.S. për të bërë verifikimin se i njëjti a gjendet në shtëpi, si D. kamionin ia ka dhënë një fshatari që të shërbehet me të, gjegjësisht që të bartë ushqim për kafshë, tani të akuzuarin e kanë takuar në fshatin ku e kanë njoftuar që të shkojë në stacionin policor. *Nga pozita që kanë pasur gjatë përcjelljes së kamionit nuk kanë mundur të shohin se kush ka qenë duke drejtuar kamionin,* gjatë intervistimit D.S. ka deklaruar se tani është kthyer nga ... dhe nuk ka njohuri lidhur me rastin.

Dëshmitari I.K. në dëshminë e tij ka deklaruar, se nuk i kujtohet dita konkrete mirëpo i kujtohet kur kolegët A.TH. e SH.B. pas punës në patrullë kanë lajmëruar se gjatë patrullimit kanë pasur një problem me një kamion të dyshimtë të cilin nuk kanë mundur ta ndalin dhe pas verifikimit të kamionit është vërtetuar se kamioni ka qenë pronë e tani të pandehurit D., pas kësaj së bashku me kolegun Sh. kanë shkuar në shtëpinë e tani të pandehurit D. ku nga shtëpia ka dalur babai i tij me të cilin bisedën e ka zhvilluar kolegu Sh. dhe nuk i kujtohet saktë se çka ka thënë .

Gjykata vlerësoi dhe analizoi provat në shqyrtimin kryesor edhe ate një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës dhe erdhi në përfundim se nga këto prova nuk u vërtetua se i akuzuari ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 parag. 5 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, ashtu siç ngarkohet me aktakuzën e PTH-ës nga Gjilani.

Gjykata analizoi deklaratat të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve dhe deklaratën e dëshmitarit mirëpo nga këto deklarata vetëm vërtetoi se ditën konkrete me datën 10.06.2013, në orët e pas ditës zyrtarët policor tani të dëmtuarit A.TH. dhe Sh. B. kanë qenë të penguar në kryerjen e detyrave zyrtare edhe ate nga një vozitës i kamionit të markësme ngjyrë portokalli me „tabela të regjistrimit, në rrugën nga fshati për në fshatin ... me qëllim të kalimit të kufirit, mirëpo sipas të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve: A.TH. dhe SH.B. në shqyrtimin kryesor, të njëjtit janë deklaruar se për shkak pozitës që e kanë pasur gjatë tentimit për ta ndalur kamionin nuk kanë mundur ta shohin se kush ka qenë duke drejtuar kamionin, dyshimi i zyrtarëve policor rrjedhë vetëm nga fakti se pas verifikimit të tabelave të regjistrimit kanë vërtetuar se ai kamion është pronë e tani të pandehurit, dhe kjo ka qenë sipas zyrtarëve policor indicje-dyshim se tani i pandehuri ka qenë duke drejtuar kamionin ditën konkrete .

Gjykata në këtë çështje penalo-juridike me asnjë provë nuk mundi të vërtetoi faktin-tezën e akuzës se i akuzuari kishte kryer veprën penale për të cilën ishte ngarkuar, i pandehuri nuk është parë, nuk është identifikuar nga zyrtarët policor se ka qenë duke drejtuar kamionin ditën konkrete, i pandehuri si në deklaratën dhënë para zyrtarëve policor ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor ka mohuar në tërësi faktin se ditën konkrete ka qenë duke drejtuar kamionin ashtu siç ngarkohet me aktakuzë, i njëjti ka deklaruar se ditën konkrete në kohën kur pretendohet se ka kryer veprën penale ka qenë në dhe nga

babai i tij ka kuptuar se kamionin ditën konkrete e ka shfrytëzuar një fshatar, *andaj gjykata vie në përfundim se kjo aktakuzë është ngritur me të vetmin pretendim, se, kamioni ka qenë pronë e D.S.*, kështu që në rastin konkret gjykata nuk pati asnjë provë të vetme për të vërtetuar fajësinë për të pandehurin. Sipas dispozitave të KPPRK-së përgjegjësia penale duhet të vërtetohet në mënyrë bindëse, pra në rastin konkret nuk është vërtetuar e njëjta, andaj, në mungesë të provave i akuzuari nuk është shpallur fajtor.

Gjykata vlerëson se përgjegjësia penale duhet të provohet, askush nuk mund të shpallet fajtor në bazë të supozimeve pa pasur prova të drejtëpërdrejta të cilat do ta përshkruanin me saktësi ekzistimin e fakteve përkitazi me kryerjen e veprës penale, pra mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij në mbështetje të nenit 3 parag. 2 të KPPRK-së.

Të dëmtuarit A.TH. e SH.B. nuk parashtruan kërkesë pasurore juridike.

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 454 parag. 1 i KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

P.nr.249/2013, më datën 19.12.2016

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r j a,

Emine Zubaku,d.v.

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.